

Vendim nr. 114 datë 29.05.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Marjana Semini, Anëtare

Sandër Beci, Anëtar

në datën 29.05.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (Xh) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: XHEVDET BALLOLLI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 229/10-2014-1027, datë 27.02.2014 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2022-3766, datë 09.11.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, pika 2, 15, 17, 41, pika 2, 42, pika 1, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. *Kërkuesi*, Xhevdet Ballolli dhe i ndjeri Petrit Ballolli kanë qenë vëllezër. Ky i fundit ka vdekur në vitin 2002, duke lënë si trashëgimtarë ligjorë familjarët e tij, gruan dhe tre fëmijët, me të cilët kërkuesi është në konflikt për bashkëpronësinë e një trualli 200 m² dhe ndërtesës dykatëshe të ngritur mbi të, me sipërfaqe 133.7 m², në qytetin e Gramshit.

2. Kërkuesi ka pretenduar se trualli dhe banesa objekt konflikti janë pronë e përbashkët e vëllezërve Ballolli, banesë e cila është ndërtuar me të ardhurat nga shitja e shtëpisë së lënë trashëgim nga babai i tyre, por edhe nga kontributi i përbashkët financiar i të tre vëllezërve gjatë kohës së ndërtimit të banesës.

3. Me vendimin nr. 86, datë 20.06.1994 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh është vërtetuar fakti juridik i pronësisë së banesës dykatëshe vetëm në emër të të ndjerit Petrit Ballolli. Duke qenë se nuk është ankimuar, vendimi ka marrë formë të prerë në datën 04.07.1994 dhe nga vërtetimi i pronësisë së datës 16.10.1996, lëshuar nga zyra e hipotekës së rrethit Gramsh, kjo ndërtesë banimi rezulton e regjistruar në regjistrat hipotekorë në emër të vëllait të kërkuesit, të ndjerit Petrit Ballolli.

4. Me vendimin nr. 159, datë 17.09.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh, si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të Petrit Ballollit janë përcaktuar bashkëshortja dhe tre fëmijët e tij. Në vijim, bashkëshortja ka aplikuar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Gramsh (*ZVRPP*) për regjistrimin e pasurisë së mësipërme në emër të saj dhe tre fëmijëve.

5. Duke mos qenë dakord për sa më lart, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesëpadi, duke kërkuar detyrimin e të paditurve (trashëgimtarë të Petrit Ballollit) të njohin atë dhe Agim Ballollin si bashkëpronarë në pasurinë e paluajtshme me sipërfaqe 200 m² dhe ndërtesën mbi të 133.7 m² në qytetin e Gramshit, si dhe pjesëtimin e sendit, për të cilën, me vendimin nr. 513/43, datë 22.02.2008, gjykata ka vendosur: *“Pranimin e kërkesëpadisë. Detyrimin e të paditurve të njohin paditësit si bashkëpronar në pasurinë e paluajtshme, konkretisht me 1/3 për dy paditësit dhe 1/12 për secilin prej 4 anëtarëve të familjes së të ndjerit”*, me arsyetimin se të tre vëllezërit kanë kontribuar së bashku financiarisht për ndërtimin e banesës. Një pjesë të të ardhurave i kanë trashëguar nga babai i tyre, pas shitjes së një shtëpie në fshat dhe gjëse së gjallë, por duke qenë se gjatë kohës së ndërtimit i ndjeri ka vuajtur dënimin 1 vit e 6 muaj

burgim, kontributin themelor në ndërtimin e saj e kanë dhënë dy vëllezërit e tij Xhevdet dhe Agim Ballolli.

6. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim trashëgimtarët e Petrit Ballollit, duke pretenduar se gjykata nuk ka bërë një hetim të plotë dhe të gjithanshëm. Kërkuesi nuk vërteton me asnjë dokument se është pronar apo bashkëpronar mbi këtë pronë, në këto kushte edhe kërkesa për njohjen si bashkëpronarë është e pabazuar. Nuk është paraqitur asnjë provë që vërteton kontributin e tyre në ndërtimin e kësaj banese, në njërin nga format që njeh ligji. Gjykata, në kundërshtim me objektin e padisë, ka përcaktuar edhe pjesët takuese, duke urdhëruar ZVRPP-në, Gramsh të pasqyrojë këtë bashkëpronësi në regjistrat e hipotekës. Për sa më lart, ata kanë kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

7. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2010-59(32), datë 26.01.2010, ka vendosur: *“Prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues”*, duke arsyetuar se gjykata e rrethit nuk ka respektuar nenin 6 të Kodi i Procedurës Civile si dhe është shprehur tej asaj çka është kërkuar në gjykim, pra për pjesëtimin e pronës, ndërkohë që paditësit kishin hequr dorë nga kërkimi i pjesëtimit të saj dhe gjykata, me vendim të ndërmjetëm, kishte vendosur pranimin e kësaj kërkesë.

8. Në rigjykimin e çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 2050 datë 17.10.2011, ka vendosur: *“Pranimin e padisë, detyrimin e të paditurve të njohin si bashkëpronar edhe paditësit, si dhe urdhërimin e ZVRPP, Gramsh të bëjë pasqyrimin e kësaj bashkëpronësie”*, me arsyetimin se të gjitha palët ndërgjyqëse kanë qenë anëtarë të familjes bujqësore dhe banesa është ndërtuar me kontribut të përbashkët financiar.

9. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur përsëri ankim trashëgimtarët e Petrit Ballollit, duke kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 2050, datë 17.10.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.

10. Me vendimin nr. 229, datë 27.02.2014, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe rrëzimin e padisë, me arsyetimin se në gjykimet me objekt njohjen e pronësisë, vendimi që jep gjykata ka karakter thjesht njohës (*deklarativ*), për rrjedhojë nuk detyron të paditurit të kryejnë ndonjë veprim (*p.sh., dorëzimin e sendit ose pushimin e veprimeve që cenojnë pronësinë e paditësit, ndërprerjen e punimeve etj*). Sipas gjykatës, pretendimet e kërkuesit përbëjnë kërkim klasik të njohjes së pronësisë dhe dispozitat e parashikuara, konkretisht nenet 200 dhe 207 të Kodit Civil (KC), nuk

paraqesin asnjë relacion të rregullt me pretendimin e ngritur prej tij. Po sipas saj, situata juridike paraqitet ndryshe, palët paditëse nuk gëzojnë efektivisht ndonjë të drejtë pronësie mbi objektin banesë. Duke qenë se bëhet fjalë për një marrëdhënie juridike që ka lindur shumë kohë më parë, në vitin 1974, kur është ndërtuar kjo banesë, edhe dispozitat ligjore duhet t'i referoheshin asaj kohe. Palët paditëse kanë zgjedhur referenca ligjore të gabuara, ndërsa palët e paditura e kanë fituar të drejtën e pronës me trashëgimi nga trashëgimlënësi, i ndjeri Petrit Ballolli, në vitin 1994. Pra, bëhet fjalë për veprime të kryera bazuar në KC të shumë kohëve më parë dhe vendimi gjyqësor nr. 86, datë 20.06.1994 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh konsiderohet akt i fitimit të pronësisë në fjalë, e cila është regjistruar rregullisht në ZVRPP-në, Gramsh, në përputhje me nenin 127 të KC-së së vitit 1981. Paditësit e kanë bazuar kërkimin e tyre vetëm në faktin se kanë kontribuar në ndërtimin e banesës.

11. Kundër këtij vendimi kërkuar ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar prishjen e vendimit nr. 229, datë 27.02.2014 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 2050, datë 17.10.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

12. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-3766, datë 09.11.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuar, me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe ligjore nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Kolegji Civil ka vlerësuar se arsyetimi dhe përfundimi i arritur nga gjykatat e faktit janë rrjedhojë e zbatimit të kërkesave të ligjit material dhe atij procedural. Nga gjykata e apelit janë respektuar normat procedurale. Nuk ka shkelje të rënda procedurale, të cilat ndikojnë në dhënien e vendimit. Palëve u është dhënë mundësia e mbrojtjes, të paraqesin prova apo të njihen me to. Gjykatat kanë kryer hetime të plota, të gjithanshme, duke u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve, bazuar në nenet 14 dhe 16 të KPC-së. Pretendimet e palëve që ngrejnë çështje të vlerësimit të provave, dalin jashtë juridiksionit të Gjykatës së Lartë.

13. Në datën 10.03.2023 kërkuar i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve sipas objektit të ankimit.

II

Pretendimet e kërkuar

14. *Kërkuar*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

14.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

- 14.1.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi duke disponuar me mospranimin e rekursit, Gjykata e Lartë i ka privuar të drejtën që çështja të shqyrtohet në të gjitha hallkat e gjyqësorit.
- 14.1.2. *Parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Apelit Durrës e ka zgjidhur mosmarrëveshjen në zbatim dhe interpretim të gabuar të ligjit, si dhe në kundërshtim me të. Referuar KC-së së vitit 1981, gjykata e ka konsideruar vendimin e vërtetimit të faktit juridik si mënyrë të fitimit të pronësisë, ndërkohë që vendime të tilla janë thjesht deklarative dhe pa efekte detyruese.
- 14.1.3. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi gjykata e apelit i referohet vendimit njësues nr. 9/2006 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (KBGJL), ndërkohë që nuk merr në konsideratë vendimin unifikues të KBGJL-së nr. 3/2012, i cili u iniciua pikërisht nga nevoja për të qartësuar në praktikë interpretimin e saktë të vendimit njësues nr. 9/2006.
- 14.1.4. *Parimit të barazisë së armëve*, pasi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë bazuar vendimet e tyre vetëm në provat e palës së paditur, duke i mbivlerësuar ato në raport me provat e tij. Në vendimin e saj Gjykata e Apelit Durrës ka marrë për bazë vetëm pretendimet e të paditurve, sipas të cilëve në ndërtimin e shtëpisë ka kontribuar vetëm trashëgimlënësi, i ndjeri Petrit Ballolli, ndërsa dy vëllezërit e tjerë thjesht e kanë ndihmuar fizikisht si vëllezër.
- 14.2. *Së drejtës së pronës private*, pasi Gjykata e Lartë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës, i cili nuk e ka njohur kërkesin si bashkëpronar në pasurinë e paluajtshme objekt konflikti, duke e privuar nga posedimi dhe gëzimi i bashkëpronësisë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkesit

15. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose

juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

16. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

17. Duke analizuar respektimin e këtyre kriterëve në rastin konkret, Kolegji vlerëson se kërkuuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor gjatë të cilit janë dhënë vendimet e kundërshtuara, duke provuar interesin e tij në çështjen e parashtruar.

18. Kërkuuesi ka plotësuar edhe kriterin e shterimit të mjeteve juridike, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000. Ai i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pasi ka shteruar mjetet e ankimit në formë dhe substancë dhe pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyimit të zakonshëm. Në lidhje me pretendimet për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, kërkuuesi nuk ka mjet tjetër ankimi përveç ankimit kushtetues individual. Në thelb, pretendimet e tij janë ngritur në të gjitha shkallët e gjyimit, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se kërkuuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t’i drejtohet Gjykatës.

19. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, Kolegji vëren se kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 10.03.2023, ndërsa vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është i datës 09.11.2022. Për rrjedhojë, kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

20. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*, kërkuuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit, të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, të parimit të sigurisë juridike, të parimit të barazisë së armëve dhe të së drejtës së pronës. Në lidhje me pretendimet e mësipërme, ato *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, për rrjedhojë do të analizohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit

21. Kërkuesi ka pretenduar se duke disponuar me mospranimin e rekursit, Gjykata e Lartë i ka privuar të drejtën që çështja të shqyrtohet në të gjitha hallkat e gjyqësorit.

22. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje gjyqësore përfundimtare për mosmarrëveshjen. Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimin 14, datë 21.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, Gjykata ka theksuar se është kompetencë e Kolegjit të Gjykatës së Lartë të analizojë nëse pretendimet e parashtruara në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit, duke vlerësuar kështu nëse çështja duhet të kalojë për shqyrtim në seancë gjyqësore. Në rast se kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk gjejnë mbështetje në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, atëherë është në kompetencën e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimin nr. 6, datë 10.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Referuar dispozitave procedurale që zbatohen për shqyrtimin e rekurseve nga Gjykata e Lartë, sipas nenit 472 të KPC-së: “1. Vendimet e shpallura nga gjykata e apelit dhe ato të shkallës së parë në rastet që parashikohen në këtë Kod mund të ankimohen me rekurs në Gjykatën e Lartë: a) për zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, të një rëndësie themelore për njehsimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; b) kur vendimi i ankimuar është i ndryshëm nga praktika gjyqësore e Kolegjit Civil ose praktika e njehsuar e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; c) ka shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurës së gjykimit, sipas nenit 467 të këtij Kodi”.

24. Në rastin konkret, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe ligjore nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Ai ka vlerësuar se arsyetimi dhe përfundimi i arritur nga gjykatat e faktit është rrjedhojë e zbatimit të kërkesave të ligjit material dhe atij procedural. Nga gjykata e apelit janë respektuar

normat procedurale; nuk ka shkelje të rënda procedurale, të cilat ndikojnë në dhënien e vendimit; palëve u është dhënë mundësia e mbrojtjes, të paraqesin prova ose të njihen me to; gjykatat kanë kryer hetime të plota, të gjithanshme, duke iu dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve, bazuar në nenet 14 dhe 16 të KPC-së; pretendimet e palëve që ngrejnë çështje të vlerësimit të provave dalin jashtë juridiksionit të Gjykatës së Lartë. Në përfundim, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, bazuar në nenin 480 të KPC-së.

25. Për sa më lart, në kundërshtim nga sa kërkuesi pretendon, Kolegji vlerëson se mospranimi i rekursit është vendosur në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, në përputhje me kompetencat e dhëna me ligj Gjykatës së Lartë, dhe vetëm fakti se është disponuar me mospranim, nuk nënkupton se kërkuesit i është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë.

26. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj

27. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Apelit Durrës e ka zgjidhur mosmarrëveshjen në zbatim dhe interpretim të gabuar të ligjit dhe në kundërshtim me të. Referuar KC-së së vitit 1981, gjykata e ka konsideruar vendimin e vërtetimit të faktit juridik si mënyrë të fitimit të pronësisë, ndërkohë që vendime të tilla janë thjesht deklarative dhe pa efekte detyruese.

28. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “gjykatë e caktuar me ligj”. Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 7, datë 23.02.2021; nr. 27, datë 24.06.2013; nr. 22, datë 22.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në rastin konkret, Gjykata e Apelit Durrës ka arsyetuar se ndryshe nga sa ka pretenduar kërkuesi: “ [...] situata juridike në rastin e paraqitur për shqyrtim paraqitet krejt ndryshe Xhevdet Ballolli nuk gëzon efektivisht në momentin e ngritjes së padisë dhe aktualisht

ndonjë të drejtë pronësie mbi shtëpinë dykatëshe të banimit në qytetin e Gramshit... gjithashtu i vlerësuar pretendimi i palës *ratione temporis*, konstatohet se marrëdhënia juridike lidhur me të drejtën reale të pretenduar ka lindur shumë kohë përpara se të hynte ne fuqi KC-ja e vitit 1994. Fjala është për vitin 1974, koha kur pala paditëse pretendon se ka përfunduar ndërtimi i shtëpisë së banimit me kontributin e të gjithë anëtarëve meshkuj të saj në atë kohë. Për rrjedhojë, zgjedhja e dispozitës ligjore materiale të zbatueshme duhet të respektoje kriterin kohë...”. Po sipas saj: “[...] palët janë trashëgimtarë të të ndjerit Petrit Ballolli, i cili kishte të regjistruar në ZVRPP- në Gramsh këtë shtëpi banimi me sipërfaqe të përgjithshme të truallit 200 m² dhe sipërfaqe ndërtimore 133.7 m². Regjistrimi i kësaj pasurie në favor të trashëgimtarëve Petrit Ballolli është bazuar në vendimin civil nr. 86, datë 20.06.1994 të Gjykatës së Rrethit Gramsh, përmes të cilit është vërtetuar fakti juridik i pronësisë së Petrit Ballollit mbi shtëpinë e banimit në konflikt dhe që ka marrë formë të prerë në datën 04.07.1994. Pra bëhet fjalë për veprimin e efekteve të Kodit Civil të vitit 1981”, dhe se bazuar në nenin 126 të Kodit Civil të vitit 1981 parashikohet se “Pronësia fitohet edhe në... bazë të vendimit të gjykatës” (shih faqet 11-12 të vendimit nr. 229, datë 27.02.2014 të Gjykatës së Apelit Durrës).

30. Në analizë të këtij arsyetimi, Kolegji konstaton se gjykata e apelit i ka dhënë përgjigje të argumentuar dhe të arsyetuar kërkuarit, bazuar në prova dhe në ligjin përkatës. Në këtë këndvështrim, nuk rezulton që gjykata të ketë vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore materiale dhe procedurale, që përcaktojnë kuadrin ligjor për zgjidhjen e çështjes së paraqitur për shqyrtim para saj. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuarit kanë të bëjnë, në thelb, me vlerësimin e provave, interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga gjykata e juridiksionit të zakonshëm gjatë procesit gjyqësor, çka nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues.

31. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj është haptazi i pabazuar.

Ç. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

32. Kërkuari ka pretenduar se gjykata e apelit i referohet vendimit njëses nr. 9/2006 të KBGJL-së, ndërkohë që nuk merr në konsideratë vendimin unifikues të KBGJL-së nr. 3/2012, i cili u iniciua pikërisht nga nevoja për të qartësuar në praktikë interpretimin e saktë të vendimit njëses nr. 9/2006.

33. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i shtetit të së drejtës ku mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me

qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Parimi i sigurisë juridike nënkupton edhe besimin e individëve te sistemi juridik, shteti dhe institucionet e tij, si dhe aktet që ato nxjerrin (*shih vendimin nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Cenimin e këtij parimi Gjykata e ka parë të lidhur ngushtë edhe me parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*), cenimi i të cilit do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues e ligjorë të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike (*shih vendimin nr. 2, datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Në këtë kuptim, Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës së Lartë autoritetin të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore, pra të mbajë qëndrime në çështje të veçanta, me qëllim unifikimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme. Ky funksion ushtrohet nga Gjykata e Lartë duke tërhequr për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara. Kjo vjen si pasojë e pozicionit të saj si organi më i lartë i sistemit gjyqësor dhe lidhet me funksionin e përgjithshëm të saj për të siguruar uniformitetin e interpretimit të normave ligjore nga ana e gjyqtarëve të zakonshëm, përmes përcaktimit të linjave të interpretimit, të cilave gjyqtarët duhet t'u përmbahen (*shih vendimet nr. 47, datë 03.07.2017; nr. 6, datë 17.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, qëllimi i Gjykatës nuk është të vërë në diskutim vlerën që kanë vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë në rendin juridik dhe as detyrimin ligjor që kanë gjykatat më të ulëta që të marrin parasysh dhe zbatojnë në çështje analoge zgjidhjet e dhëna në këto vendime (*shih vendimin nr.26, datë 22.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Në rastin konkret, në analizë të pretendimeve të kërkuarit, Kolegji vëren se pavarësisht arsytimit të Gjykatës së Apelit Durrës, në referim, ndër të tjera, edhe të vendimit unifikues nr. 9/2006 të KBGJL-së, ndryshimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe rrëzimi i kërkesëpadisë së kërkuarit nuk është pasojë e zbatimit të gabuar të ligjit nga gjykata e apelit, pasi ajo në vendimin e saj është shprehur se “*[...] baza juridike e gabuar e kërkesëpadisë, pra që nuk rregullon në thelb materialisht konfliktin, është premisë e mjaftueshme për të deklaruar gjykata papranueshmërinë e pretendimit, çka formalisht shfaqet si disponim i rrëzimit të padisë*”, por më tej ajo praktikisht ka vepruar në zbatim të vendimit unifikues nr. 3/2012, pasi ka marrë në shqyrtim duke e trajtuar në themel çështjen, pra duke arsyetuar për të gjitha faktet dhe pretendimet, dhe në përfundim ka vendosur për rrëzimin e saj.

36. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të sigurisë juridike është haptazi i pabazuar.

D. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve

37. Kërkuesi ka pretenduar se gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë bazuar vendimet e tyre vetëm në provat e palës së paditur, duke i mbivlerësuar ato në raport me provat e tij. Në vendimin e saj Gjykata e Apelit Durrës ka marrë për bazë vetëm pretendimet e të paditurve, sipas të cilëve në ndërtimin e shtëpisë ka kontribuar vetëm trashëgimlënësi, i ndjeri Petrit Ballolli, ndërsa dy vëllezërit e tjerë thjesht e kanë ndihmuar fizikisht.

38. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, Gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 28, datë 22.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Duke e vlerësuar procesin gjyqësor të zhvilluar në çështjen e kërkuesit në tërësinë e tij, Kolegji vëren se ai ka qenë i pranishëm gjatë gjykimit në gjykatën e apelit, duke iu dhënë mundësia të dëgjohet dhe të paraqesë provat e tij, në kushte të barabarta me palën kundërshtare, të debatohet në lidhje me to, si dhe të paraqesë argumente e prova në mbështetje të pretendimeve të tij. Po kështu, ai ka ushtruar lirisht të drejtën e rekursit, duke parashtruar të gjitha pretendimet e tij në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës së apelit dhe nuk rezulton të jetë vënë në situatë jo të favorshme në krahasim me palën tjetër. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre janë në juridiksion të gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues.

40. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve është haptazi i pabazuar.

E. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së pronës private

41. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës, i cili nuk e ka njohur si bashkëpronar në pasurinë e paluajtshme objekt konflikti, duke e privuar nga posedimi dhe gëzimi i bashkëpronësisë.

42. Neni 41 i Kushtetutës garanton të drejtën e pronës private (*pika 1*), e cila fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në KC (*pika 2*). Po sipas kësaj dispozite kushtetuese, ligji mund të parashikojë kufizime në ushtrimin e kësaj të drejte vetëm për interesa publike (*pika 3*) dhe se kufizimet lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë (*pika 4*), për masën e të cilit mund të bëhet ankim në gjykatë (*pika 5*). Kriteret që parashikon neni 41 i Kushtetutës, që janë garantimi i pronës private dhe shpërblimi i drejtë, si dhe koncepti i përcaktuar nga KEDNJ-ja për gëzimin e pronës në mënyrë të qetë, janë orientimet bazë mbi të cilat duhet të zgjidhen të gjitha çështjet që lidhen me shpronësimet dhe kufizimet e pronës.

43. Në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose joproporcionale i së drejtës së pronës. Megjithatë, me gjithë mbrojtjen që ajo gëzon, e drejta e pronës mund t'u nënshtrohet kufizimeve, të cilat duhen bërë sipas disa kriterëve të përcaktuara në mënyrë shteruese në nenin 17 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 15, datë 22.06.2022; nr. 25, datë 28.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

45. Bazuar në sa më sipër, Kolegji vëren se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së pronës është i lidhur ngushtë me të drejtën për proces të rregullt ligjor. Në kushtet kur në përfundim të analizës së lartpërmendur nuk rezultojnë shkelje të kësaj të drejte, vlerësohet se edhe pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës është haptazi i pabazuar.

46. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.